



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : **Rregullimi i kulmeve “ , Nr. i prokurimit- 632-22-7718-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-077-521**, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, e dt.03.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Rregullimi i kulmeve “ , Nr. i prokurimit- 632-22-7718-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-077-521**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** , te AK –së, të datës 27.09.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 27.09.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.03.10.2022, Operatori Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **Rregullimi i kulmeve “ , Nr. i prokurimit- 632-22-7718-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-077-521**.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë se Operatorit ekonomik të propozuar për nënshkrim të kontratës Roza Komani B.I., i mungojnë kontratat e punëtorëve nuk qëndron, sepse në ofertën e operatorit në fjalë (të cilën e keni marrë përmes qasjes në dokumente) është lista dhe kontratat e punëtorëve që kanë emrin e tyre në atë listë.

Autoriteti kontraktues ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm, dhe ky operator ka ofruar dëshmi se i ka (ka prezantuar kontratat e punës të 10 prej punëtorëve që gjenden në atë listë).

Pretendimi juaj i dytë se ju keni mbi 500,000.00€ referenca, nuk qëndron sepse te :

- “Renovimi I kulmit në qerdhen “Ganimete Tërbeshi” në Gjakovë në vlerë prej 43,943.19 €, keni prezantuar kontratën dhe referencën dhe plotëson kërkesat e Autoriteti kontraktues në FDT;
- “Renovime në fushën e futbollit të klubit futbollistik “Dushkaja” në Gjakovë “në vlerë prej 9,319.48€, keni prezantuar kontratën por jo edhe referencë, kështu që nuk plotëson kërkesat e Autoriteti kontraktues në FDT;
- Rivitalizimi I Urës së Fshejtë & kanjoni, ndriçimi, shtigjet për ecje, në vlerë prej 65,202.00 €, keni prezantuar kontratën dhe referencën, mirëpo referenca është në vlerën prej 58,302.00€ d.m.th. punët nuk janë përfunduar dhe si e tillë nuk plotëson kërkesat e Autoriteti kontraktues në FDT.

Pjesa tjetër e kontratave të prezantuara nga ju janë ndërtim i ulët dhe nuk plotëson kërkesën e Autoriteti kontraktues në FDT, sepse punët që i përkasin ndërtimit të ulët nuk mund të llogariten si punë të ngjashme për ndërtimin e lartë .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës